



Prishtinë: 10.07.2019  
Kodi i ZRRE-së: V\_1174\_2019

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_1948\_05\_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **28.06.2019**.

### në seancën e mbajtur më datë 10.07.2019, nxori këtë:

#### V E N D I M

- I **REFUZHET** ankesa e KESCO-së ndaj vendimit të DMK-së për konsumatorin B.M. nga Prishtina, me shifër të konsumatorit DPR 90112000, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK\_V\_1948\_05\_19** i datës 27.05.2019.

#### A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 28.06.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së, i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë për këto shkaqe: Përfaqësuesi i KESCO-së, në ankesë ka theksuar se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në njehsorin nr.39215003 ka qenë e verifikuar nga qendra e kalibrimit dhe është konstatuar përmes procesverbalit nr.0390610 i datës 26.03.2015 ku objekti është i lidhur në rrjetin elektrik pa Pëlqim elektroenergjetik, si dhe njehsori nr.39215003 ka pasur shpenzim prej 2752 kWh. KESCO në ankesë ka theksuar se arsyetimi i DMK në ZRRE ka mund të jetë bërë ngatërrim në faturimin e kWh të njehsorit nr.3699006 dhe nr.39215003 nuk qëndron pasi ekipet e KEDS-it njehsorin nr.39215003 e kanë evidentuar si njehsori të paregjistruar, si dhe objekti është i kyçur në rrjet pa Pëlqim Elektroenergjetik (PEE). KESCO thekson se këta njehsor ka qenë të vendosur nga vet konsumatori dhe përderisa objekti nuk ka pasur PEE atëherë kanë qenë ilegal, dhe se posa objekti ka marrë PEE nga KEDS atëherë janë regjistruar njehsorët e vendosur nga konsumatori dhe janë regjistruar konsumatorët dhe për secilin konsumator është bërë faturimi. KESCO në ankesën e tyre kanë theksuar se kërkojnë nga Bordi i ZRRE-së që pezullojnë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_1948\_05\_19 i datës 27.05.2019 për konsumatorin B.M. me shifër DPR – 90112000.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për



Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO-s se gjendja e shpenzimit të energjisë elektrike në njehsorin nr.39215003 ka qenë e verifikuar nga qendra e kalibrimit dhe është konstatuar përmes procesverbalit nr.0390610 i datës 26.03.2015 ku objekti është i lidhur në rrjetin elektrik pa Pëlqim elektroenergetik, si dhe njehsori nr.39215003 ka pasur shpenzim prej 2752 kWh, Bordi i ZRRE thekson sipas të dhënave të evidentuara nga punëtorët e KEDS-it në procesverbalin e pranimit të instalimit të njehsorit elektrik nr.0086693 të datës 25.04.2016, konstatohet se njehsori elektrik nr.3699006 me gjendje të shpenzimeve prej TL=1687 kWh dhe TU=712 kWh, ka qenë i vendosur për matje para pranimit teknik, si dhe në këtë procesverbal theksohet se konsumatori ka PEE dhe se në këtë procesverbal nuk është theksuar asnjë çështje lidhur me njehsorin kotnestues nr.39215003. Gjithashtu Bordi i ZRRE-së thekson se sipas transaksioneve të konsumatorit vërtetohet se të njëjtit i është hapur shifra DPR-90112000 me datë 03.05.2016 duke e ngarkuar me faturën për shërbime në vlerë 11.80 € dhe se shpenzimin e energjisë elektrike (kWh) të evidentuar në procesverbal janë faturuar në periudhën 05/2016. Bordi i ZRRE-së gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se KESCO me datë 01.08.2016 i ka dërguar konsumatorit dy fatura mujore për periudhën 07/2016, faturën jo të rregullt nr.0716210412DPR-90112000 me shpenzim prej 2,752 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 194.80€ e me njehsor elektrik nr.39215003, si dhe faturën e rregullt mujore të energjisë elektrike për periudhën korrik 2016 me shpenzim prej 320 kWh apo e shprehur në vlerë financiare 19.97€ e me njehsor elektrik nr.39699006.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO se organi i shkallës së parë ka theksuar se te rasti i konsumatorit është bërë ngatërrim në faturimin e kWh të njehsorit nr.3699006 dhe nr.39215003, Bordi i ZRRE-së thekson se vendimi i organit të shkallës së parë nuk ka potencuar se është bërë ngatërrim të njehsorëve elektrike, por që ka theksuar se ka paqartësi të mëdha mes vet shkresave të KEDS-it, si dhe nuk janë dhenë sqarimet e nevojshme nga të licencuarit KEDS dhe KECO për këto paqartësi rreth njehsorëve elektrik. Bordi i ZRRE thekson se gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka vërejtur se KESCO dhe KEDS konsumatorit në periudhën 05/2016 i ka bërë regjistrimin e njehsorit elektrik nr.39699006 dhe atë me shpenzim prej TL=1844 kWh dhe TU=748 kWh, e që kjo tregon qartë se njehsori elektrik i konsumatorit ka qenë i vendosur për matje para pranimit teknik, ndërsa në periudhën 06/2016 është faturuar vetëm me taksë por pa shpenzim. Nga shkresat e vet KEDS dhe KESCO vërehet se konsumatorit në fjalë në periudhën 07/2016 i evidentuar dhe regjistruar njehsori elektrik nr.39215003 me gjendje TL=2752 kWh dhe TU=0 kWh e cila gjendje edhe i është faturuar konsumatorit, por që në të njëjtin muaj 07/2016 prapë kemi faturim prej TL=219 kWh dhe T=101 kWh, por tani me njehsorin elektrik nr.39699006. Bordi i ZRRE-së thekson se te rasti i konsumatorit kemi të bëjmë me mos lexim dhe faturim të saktë, e kjo pasqyrohet edhe për periudhën qershor 2016 me njehsorin elektrik nr.39699006 ku shihet nuk kemi fare faturim të energjisë elektrike apo shpenzim të regjistruar, pastaj faturimi i shpenzimit prej 2,752 kWh në tarifën e lartë me njehsorin elektrik nr.39215003 në periudhën 07/2016, si dhe kthimi i gjendjes së shpenzimeve në CCP për periudhën 07/2016 prapë me njehsorin nr.39699006, ku nga gjendja në tarifën e lartë TL=2752 kWh me njehsorin nr.39215003 është bërë TL=2063 kWh me njehsorin nr.39699006. Bordi i ZRRE gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës thekson se në përgjigjen e KESCO dhënë konsumatorit nuk është evidentuar se konsumatori në periudhën 07/2016 të ketë njehsorin nr.39215003 dhe pastaj në të njëjtin muaj prapë të kthehet njehsori tjetër nr.3699006, gjë për të cilën do të duhej nga KESCO të ipej arsytim se si ka ardhur deri ty shpenzim apo faturim i këtij njehsori dhe prapë është kthyer njehsori i vjetër, ngase konsumatori ka parashtruar ankesë për faturën e muajit 07/2016, e ky kjo faturë sipas rrjedhës është e evidentuar me njehsorin elektrik nr.39699006, apo që është bërë ndonjë gabim në evidentimin e njehsorit elektrik nr.39215003, por që përgjigja e KESCO ka qenë që vendimi bazohet në procesverbalin nr.21211734 të datës 17.04.2017.



Sa i përket pikës së kundërshtimit të KESCO se këta njehsor kanë qenë të vendosur nga vet konsumatori dhe përderisa objekti nuk ka pasur PEE atëherë kanë qenë ilegal, dhe se posa objekti ka marrë PEE nga KEDS, atëherë janë bërë regjistrimet e njehsorëve dhe faturimi i shpenzimit, Bordi i ZRRE thekson se bazuar në shkresat e lëndës, veçanërisht në analizën e rrjedhës së energjisë elektrike, procesverbalit të inspektimit nr.2122734 të datës 17.04.2017, si dhe listave të leximit për periudhën 05/2016 deri në periudhën 10/2017 konstatohet qartë se fatura nr.0716210412DPR-90112000 e datës 01.08.2016 nuk paraqet faturim real mujor të konsumatorit, pasi që KESCO nuk ka arritur të argumentojë se si ka ardhur deri te ky faturim. Bordi i ZRRE-së thekson se gjatë analizës së bërë listave të leximit për periudhën 05/2016 deri në periudhën 10/2017 konstatohet se lexuesi i KEDS-it në periudhën 05/2016 ka evidentuar njehsorin elektrik nr.39699006, në periudhën 06/2016 ka evidentuar njehsorin elektrik nr.39215003 dhe ka theksuar se njehsori është brenda, në periudhën 07/2016 ka evidentuar njehsorin elektrik nr.39215003 dhe ka theksuar se leximi është bërë përmes CCP, në periudhën 08/2016 ka evidentuar njehsorin nr.39699006, në periudhën 10/2016 lexuesi ka evidentuar se kemi mungesë të bllobës, dhe në të gjitha rastet e tjera ka evidentuar shpenzimet reale mujore. Andaj Bordi i ZRRE-së duke u bazuar në të gjitha shkresat e lëndës konstaton se vendimi i organit të shkallës së parë që të shkarkon konsumatorin nga fatura nr.0716210412DPR-90112000 të datës 01.08.2016 në vlerë prej -194.80€, si dhe të korrigjoj faturën nr.06160DPR-90112000 të datës 01.07.2016 dhe nr.07160DPR-90112000 të datës 01.08.2016 në vlerë prej **-1.66€**, pra duke bërë shpërndarjen e shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 06/2016 - 07/2016 është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 10.07.2019 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Arsim Janova, u.d. kryesues

---

Besim Sejfiqaj, anëtar

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

**Vendimi iu dërgohet:**

- KESCO-së, dhe
- Konsumatorit B.M dhe
- Arkivit të ZRRE-së.